



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Ac.nr.239/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit I.S. nga fshati ....., Komuna e Podujevës, tani me vendbanim në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.SH., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “....” sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.B., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.375/14 datë 10.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit I.S. nga fshati .... Komuna e Podujevës, me vendbanim në Prishtinë dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “....” sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.375/14 i datës 10.06.2019, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.375/14, të datës 10.06.2019, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që: Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit I.S. nga Prishtina dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimit “....” në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material të pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut, i cili ka ndodhur me datën 11.06.2013 t’ia paguaj dhe atë: për dhimbje shpirtërore fizike shumë prej 1.600 €, për frikën e përjetuar shumë prej 1.300

€, në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 117 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 100 €, për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumë prej 120 €, të gjitha me kamatë prej 8 %, duke llogaritur nga data 10.06.2019, e deri në pagesën definitive. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e gjykuara dhe atë: për dhimbje trupore fizike shumë prej 1.600 €, deri në 5.500 €, për përjetimin e frikës mbi shumë prej 1.300 € deri në 6.000 €, për ndihmën dhe kujdesin e huaj mbi shumë prej 120 € deri në 225€ si dhe refuzohet në tërësi kërkesa e padisë me të cilën paditësi ka kërkuar që në emër të rehabilitimit klimatik t'ia paguaj shumë prej 250€. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “ ....” në Prishtinë që paditësit shumën e gjykuara në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 674.40 € t'ia paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënim të përmbarrimit forcërisht.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën e paditësit, ashtu që të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykojë vlera më të larta të shpërblimit të dëmit jomaterial.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shpenzimeve të procedurës kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës të ndryshojë aktgjykimin e atakuar në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në lartësinë e kërkesëpadisë për format e dëmit jomaterial si dhe ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar në pikën III, të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, ashtu që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 05.02.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e dëmit jo material dhe material të shkaktuar me fajin e të siguruarit të të paditurës me datë 11.06.2013, në atë mënyrë që drejtuesi i automjetit të siguruar të e paditura “...” me targa..... , e ka goditur paditësin i cili ishte duke qëndruar jashtë në tavolinën e një lokali në rr. “.....” në Prishtinë, nga e cila goditje paditësi ka pësuar lëndime trupore të përshkruar si në ekspertizën mjekësore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.375/14, të datës 10.06.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga raporti i aksidentit nr. .... i datës 11.06.2013 gjendja faktike sa i përket mënyrës se si ka ndodhur

aksidenti nuk ka qenë kontestuese për të paditurën, andaj në këtë drejtim gjykata nuk ka administruar ndonjë provë. Nga raporti i Emergjencës - Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nr. ... datë 11.06.2013 si dhe dokumentacioneve tjera mjekësore për paditësin rezulton se i njëjti i është nënshtruar trajtimit mjekësor në Emergjencë - QKUK Prishtinë, si dhe në klinikat tjera për shkak të aksidentit dhe lëndimeve të pësuar në të për vizita mjekësore dhe medikamente, ndërsa sipas kuponëve fiskal të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se paditësi nga data e shkaktimit të aksidentit e tutje ka pasur shpenzime për vizitat mjekësore dhe medikamente.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jomaterial dhe material, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Avdullah Fazliu ortoped - traumatolog dhe Dr. Valdete Sereqi psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në ekspertizën mjekësore, kanë konstatuar se paditësi si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar lëndime trupore dhe atë: ndrydhje në regjionin e femurit dhe gjurit të djathtë, edeme në regjionin e femurit të majtë, plagë prerëse në gishtin II, dora e majtë, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe atë: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 30 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 15 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët posedon edhe sot e kësaj dite. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Ndiqja e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 15 ditë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 15 ditë. Terapia fizikale ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditësh për vitin e parë në ndonjë Qendër Rehabilituese. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare me intensitet të lartë në kohëzgjatje prej 24 orë, frikë sekondare me intensitet të mesëm 4 javë dhe frikë sekondare me intensitet të ulët që ka vazhduar edhe për 3 muaj.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136, 137, 159, 169 dhe 183 të LMD-së. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 382 paragraf 2 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 2, 453 dhe 463 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet

përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë.... , rreth orës .... minuta, në rrugën “...” në Prishtinë, përkatësisht përpara lokalit Hamburger “...”, ndërsa automjeti më të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te këtu e paditura. Të gjitha rrethanat vendimtare nuk janë kontestuar nga palët. Gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, siç është deklaruar përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.06.2019, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, nuk ka kontestuar se paditësi ka përjetuar dhembje fizike dhe frikë, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, drejt ka vërtetuar gjendjen faktike. Në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, në seancën shqyrtimit kryesor të datës 10.06.2019 i ka ofruar shumën në lartësi prej 1.000 €, të cilën ofertë paditësi nuk e ka pranuar. Në këtë rast e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesëpadsisë, e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia, edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadsisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit gjenë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore nga të dyja palët, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial dhe atë: për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në ekuivalencë më të mirën e shkelur, duke siguruar që kompensimi të shërbej si satisfacion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuara si më lartë, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë, siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit

përkatësisht dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së, duke vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadiës rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të huaj prej 15 ditësh dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 15 ditë, të njëjtat i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve të dëmtuarve ia njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për shpenzimet e shërimit, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këto kategori të dëmit gjen mbështetje në nenin 179 të LMD-së. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit i janë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera e lartësia e tyre është vërtetuar me prova dhe atë: kuponët fiskal dhe dëftesë pagesat prezent në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë.

Lidhur me pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, për kompensimin e dëmit jomaterial për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar dhe për kompensimin e dëmit material për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe rehabilitimin klimatik, mbi shumat e gjykuara, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se në këtë rast shumat e kërkuara nga paditësi kanë qenë të larta në krahasim me lëndimet e natyrës së lehtë të konstatuara nga ekspertet mjekësor dhe se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do t'i shërbente qëllimit të kompensimit të dëmit.

Gjykata e Apelit si të drejtë e vlerëson edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me lartësinë e kamatës së gjykuar, pasi lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 10.06.2019, e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij është vënë në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa

e tij për kompensim bëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.239/20, me datë 04.04.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli